



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 56 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-1/298-10, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nxjerr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E AKTIVITETEVE SPORTIVE

Neni 1

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike e OJQ-Klubeve sportive në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve sportive ofrohet nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodit ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet e përmendura në nenin shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 2.3. Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-030/03-0027293/18
Podujevë, 30 mars 2018



Kryetari i Komunës
Agim Veliu